

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6970
E mërkurë, 16 gusht 2023
Çmimi 0.40 €

Viti i ri shkollor fillon
më 1 shtator



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

ZYRTARI I VETËVENDOSJES, BASHKË ME KATËR PERSONA TË TJERË, KAPEN ME DROGË NË VLERË 400 MIJË EURO

- Droga bartej nëpërmjet linjave të autobusëve Prishtinë - Tiranë



Pesë persona janë arrestuar në Tiranë, përfshirë dy qytetarë të Kosovës, mbi dyshimet për shpërndarje të drogës, kanë njoftuar të martën autoritetet policore në Shqipëri. Në mesin e të arrestuarve është edhe

asamblisti i Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë, Besnik Mujeci, njëherësh edhe aksionar i Ndërmarrjes Publike "Stacioni i Autobusëve". Të dyshuarit janë kapur me një dërgesë me lëndë të dyshuar narkotike prej 11 300

tabletave ekstazi MDMA, me peshë 5 093 kilogramë, që ka vlerën e rreth 400 mijë eurove në treg. Të arrestuarit i kalonin dërgesat e drogës nëpërmjet linjave të autobusëve Prishtinë - Tiranë

OSMANI: KOSOVA PO E RESPEKTON MARRËVESHJEN E BRATISLAVËS, MASAT E BE-së DËMTOJNË DIALOGUN



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

AKTUALE



DISA AVARI NË AVION, MINISTRJA E JASHTME GJERMANE NDËRPRET UDHËTIMIN F. 2

KONJUFCA TAKOHET ME SENATOREN FERNANDEZ: NJU-JORKU, SIMBOL I RAPORTEVE HISTORIKE KOSOVË - SHBA F. 5

KTHIMI NË SHKOLLA NË VERI VIHET NË PIKËPYETJE F. 6

EKONOMI



PESË KOMPANI NËN HETIMË PËR MARRËVESHJE TË RITJES SË ÇMIMIT TË VAJIT F. 8

"100 MIJË EURO PËR NJË MUAJ", KURTI KRITIKOHET PËR NUMRIN E LARTË TË KËSHILLTARËVE F. 8

SPORT



RAHMANI DUHET TË PRESË ENDE PËR DEBUTIM F. 10

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Mavraj reagon për fushatën linçuese ndaj portalit “Nacionale” dhe gazetarëve të saj

PRISHTINË, 15 GUSHT - Botuesi i gazetës “Epoka e re”, Muhamet Mavraj, në “Facebook” ka reaguar në lidhje me fushatën linçuese kundër portalit online “Nacionale” dhe gazetarëve të saj. Në një pankartë të vendosur në qytetin e Prizrenit, ku shihen fotografitë e gazetarëve, Vullnet Krasniqi e Berat Buzhala, thuhet “Drejtësi për popullin, dënim për përçarësit. Bojkoto Nacionale. Liria e shprehjes merr fund tek ofendimi”.

Mavraj ka theksuar se Kosova po dënohet dhe do të dënohet nga këto fushata të rrezikshme kundër medieve dhe kundër demokracisë perëndimore. “Në fund të ditës e në fund të meselesë, Kosova jonë po dënohet dhe do të dënohet nga këto fushata të rrezikshme kundër medieve dhe kundër



demokracisë perëndimore. Kot e nullosoin lajmëtarin për ta bërë të pabesueshëm lajmin. Me krejt çfarë di të ndërtoj një shprehje, një qëndrim: shpreh indinjatë, dëshpërim, zhgënjim dhe dënim kundër këtij linçimi ndaj gazetarëve të ‘Nacionales’ me nënkuptim të copëtimit të kasapit, në Prizrenin tonë historik. Kosova do të mbetet në rrugën e vet perëndimore pavarësisht prej kursit të viteve të fundit”, ka shkruar Mavraj.



Kina ndalon publikimin e shkallës së papunësisë te të rinjtë

Pekin, 15 gusht - Kina e ka ndaluar publikimin e të dhënave për shkallën e papunësisë te të rinjtë, dhe diçka e tillë është parë si indikacion për ngadalësim të ritmit ekonomik. Një zëdhënës qeveritar ka thënë se vendimi është bërë për shkak të disa ndryshimeve në ekonominë e dytë më të madhe në botë dhe shoqërinë e saj.

Në qershor shkalla e papunësisë së Kinës për grupmoshën 16-24

vjeç ka prekur rekord mbi 20 për qind. Banka Qendrore e Kinës ka marrë, po ashtu, vendim që ta zvogëlojë koston e huadhënies, në tentim e sipër për ta rritur qarkullimin ekonomik.

Të dhënat zyrtare, të publikuara të martën, kanë treguar se shkalla e papunësisë në Kinë është rritur në 5.3 për qind në korrik. Mospublikimi i të dhënave për të rinjtë ka nxitur menjëherë



reagime në rrjetin social kinez, Weibo. “Mbyllja e gojës dhe syve, a ndihmon njëmend në zgjidhje të

problemeve? Me punësim fleksibil, punësim të vogël dhe punësim të pavarur, nëse punoni vetëm për një orë, nënkupton që nuk jeni i punësuar. Mos i trajtoni me seriozitet statistikave të Byrosë së Statistikave”, ka thënë një përdorues i platformës.

Vendimi i qeverisë kineze ka ardhur pas raportimeve se rimëkëmbja ekonomike në Kinë, pas pandemisë së koronavirusit, është e ngadalshme.

Për koronavirusin është raportuar për herë të parë në dhjetor të vitit 2019 në Vuhan të Kinës. Organizata Botërore e Shëndetësisë e pati shpallur koronavirusin pandemi më 11 mars të vitit 2020. Më shumë se 6.9 milionë njerëz kanë vdekur që prej shpërthimit të pandemisë në gjithë botën. Shtetet e Bashkuara kanë regjistruar numrin më të madh të viktimave, të përcjella nga India dhe Brazili.

BE-ja bllokoi marrëveshjen e emigrantëve



BRUKSEL, 15 GUSHT - Dokumentet e rëna në duart e shtypit britanik tregojnë se Bashkimi Evropian ka bllokuar një marrëveshje, e cila do ta lejonte Londrën zyrtare t'i kthente mbrapsht në Francë azilkërkuuesit që kalojnë kanalën e “La Manshit”. Refuzimi, sipas këtyre të

dhënave, erdhi nga një prej ndihmësve më të besuar të presidentes së Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen. Politikani gjerman Bjoern Siebert u tha zyrtarëve të lartë britanikë se blloku do të refuzojë të marrë në konsideratë firmosjen e një ujdje kthimi pas Brexitit. Siebert, që është kreu i kabinetit

të von der Leyen, u shfaq sfidues në reagimin e tij gjatë një takimi kokë më kokë me Këshilltarin e Sigurisë Kombëtare të Britanisë, Sir Tim Barrow, disa kohë më parë. Kjo, sipas medieve në Londër, nënkupton se Anglia nuk do ta ketë mundësinë në të ardhmen t'i kthejë drejt Francës varkat me

emigrantë. “Daily Mail” ka parë një memo të brendshme të qeverisë britanike që përshkruan rezultatin e takimit midis Sir Tim dhe Siebert, ku britaniku thotë për zyrtarin e BE-së: Ai theksoi se Komisioni nuk është i hapur për një marrëveshje ripranimi Mbretëri e Bashkuar - BE.

Polonia mban paradën më të madhe ushtarake në dekada

Varshavë, 15 gusht - Polonia, anëtare e NATO-s, ka forcuar kufijtë në javët e fundit, me shqetësime për praninë e Wagnerit në Bjellorusinë fqinje.

Parada e Ditës së Forcave të Armatosura të vendit mund të ketë qenë një ngjarje vjetore për më shumë se një shekull, por kjo e këtij viti është më e madhja që nga Lufta e Ftohtë.

2000 ushtarë nga Polonia dhe vende të tjera të NATO-s marshojnë nëpër kryeqytetin Varshavë, së bashku me 200 pjesë pajisje ushtarake dhe 92 avionë.

Helikopterët duke përfshirë Black Hawks dhe avionë duke përfshirë F-16 dhe FA-50 fluturuan lart. Ministri i Mbrojtjes, Mariusz Blaszczak, tha: “Është gjithashtu një ditë

e përkryer për ta treguar forcën tonë, për të treguar se kemi ndërtuar forca të armatosura të fuqishme që do të mbrojnë në mënyrë efektive kufijtë tanë pa hezitim”. Parada mbahet çdo vit më 15 gusht, për ta përkujtuar fitoren e Polonisë ndaj Ushtrisë së Kuqe të Bashkimit Sovjetik në vitin 1920.



Zyrtari i Vetëvendosjes, bashkë me katër persona të tjerë, kapen me drogë në vlerë 400 mijë euro

- Droga bartet nëpërmjet linjave të autobusëve Prishtinë - Tiranë

Pesë persona janë arrestuar në Tiranë, përfshirë dy qytetarë të Kosovës, mbi dyshimet për shpërndarje të drogës, kanë njoftuar të martën autoritetet policore në Shqipëri. Në mesin e të arrestuarve është edhe asamblisti i Lëvizjes Vetëvendosje në Prishtinë, Besnik Mujeci, njëherësh edhe aksionar i Ndërmarrjes Publike "Stacioni i Autobusëve". Të dyshuarit janë kapur me një dërgesë me lëndë të dyshuar narkotike prej 11 300 tabletave ekstazi MDMA, me peshë 5 093 kilogramë, që ka vlerën e rreth 400 mijë eurove në treg. Të arrestuarit i kalonin dërgesat e drogës nëpërmjet linjave të autobusëve Prishtinë - Tiranë

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

IRANË, 15 GUSHT - Në Shqipëri janë arrestuar pesë persona të cilët janë kapur me mbi 11 mijë doza ekstazi. Fillimisht mediet në Shqipëri kanë zbuluar emrat e personave që kanë rënë në pranga për drogë. Bëhet fjalë për Besnik Mujecin, 40 vjeç, banor i Prishtinës, Mithat Ramadanin, 30 vjeç, banor i Prishtinës, Kalem Picarin, 24 vjeç, Ambra Myftarin, 28 vjeçe dhe Daniel Avdija, 26 vjeç, të tre banorë të Tiranës. Emri që bie në sy është ai i Besnik Mujecit, i cili është asamblist i Lëvizjes Vetëvendosje në komunën e Prishtinës, njëherësh edhe aksionar i Ndërmarrjes Publike "Stacioni i Autobusëve" në Prishtinë. Mujecit dhe të arrestuarve të tjerë u janë gjetur 11 300 tableta ekstazi MDMA me peshë 5 kg në vlerë 400 mijë euro. Pas raportimeve në medie, drejtori i Drejtorisë së Policisë në Tiranë, Tonin Vocaj, ka mbajtur një konferencë për medie, me ç'rast ka dhënë hollësi nga operacioni i koduar "Punisher 2", ku janë sekuestruar mijëra doza drogë ekstazi dhe kanë rënë në pranga pesë persona, dy prej të cilëve shqiptarë të Kosovës. "Nga hetimet ka rezultuar se këta shtetas, duke shfrytëzuar fluksin e sezonit turistik, i kalonin dërgesat [e drogës] nëpërmjet linjave të autobusëve Prishtinë - Tiranë. Pasi dërgesat arrinin në Tiranë, transportoheshin me vetura të marra me qira në Tiranë dhe në qytete të tjera, kryesisht bregdetare, dhe vendet e

shkëmbimit caktoheshin në vende publike me shumë lëvizje dhe fluks njerëzish", ka thënë Vocaj.

Vocaj bëri me dije se janë siguruar provat ligjore për dokumentimin e veprimtarisë kriminale të këtij grupi. Përveç tabletave të ekstazisë MDMA, atyre iu sekuestrua edhe një sasi lëndë narkotike kanabis, një automjet, si dhe pesë telefona celularë.

Sekretari për media dhe komunikim i Lëvizjes Vetëvendosjes, Arlind Manxhuka, ka konfirmuar për "Radion Evropa e Lirë" se një komision i partisë ka hapur rast disiplinor ndaj Mujecit. "Me të marrë informacionin kemi iniciuar menjëherë procedurën disiplinore me ç'rast Komisioni Disiplinor i LV-së do të mbajë mbledhje urgjente për ta trajtuar rastin në fjalë. Pas mbledhjes do t'ju njoftojmë mbi vendimin", ka thënë Manxhuka.

LV-ja ka njoftuar se e kanë përjashtuar nga partia Besnik Mujecin.

PDK-ja: Ky lloj i drogës, i shpërndarë nga narko-trafikanti i Vetëvendosjes, prejardhjen e saj e ka në Serbi

Shefi i asamblistëve të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në komunën e Prishtinës, Leutrim Retkoceri, ka kërkuar urgjentisht nga organet e rendit nisjen e hetimeve për aferën



"Droga" pas arrestimit të asamblistit të Lëvizjes Vetëvendosje, Besnik Mujeci. Retkoceri në një konferencë të jashtëzakonshme për medie ka thënë se është jashtëzakonisht shqetësuese që Mujeci është caktuar aksionar në ndërmarrjen publike "Stacioni i Autobusëve", ndërkohë që, sipas informatave të policisë së shtetit të Shqipërisë, droga është eksportuar nga Kosova në Shqipëri pikërisht me autobusë. "Besnik Mujeci nuk është vetëm një asamblist i komunës së Prishtinës. Ditë më parë, pikërisht me insistimin e partisë së tij, ai është caktuar aksionar në ndërmarrjen publike 'Stacioni i Autobusëve'. Sipas informatave të policisë së shtetit të Shqipërisë, droga është eksportuar nga Kosova në Shqipëri me autobusë. Arrestimi i asamblistit të Vetëvendosjes, aksionarit të Ndërmarrjes Publike 'Stacioni i Autobusëve', ngre dyshimet e bazuara se caktimi i tij në këtë pozitë të lartë si aksionar i kësaj ndërmarrje nuk ka qenë aspak i rastësishëm. Në të njëjtën kohë, i arrestuari, narko-trafikanti i Vetëvendosjes, Besnik Mujeci, është miku më i afërt i Gëzim Sveçlës, shefit të asamblistëve të kësaj partie në Prishtinë. Për ju që nuk e dini, Gëzim Sveçla është djali i axhës së ministrit të Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla. Kjo nuk është e tëra: Ky lloj i drogës, i shpërndarë nga narko-trafikanti i Vetëvendosjes, Besnik Mujeci, prejardhjen e saj e ka në Serbi.

këtë rrjet drogë. "Muaj më parë Lëvizja Vetëvendosje kishte provuar me pazaret më të pabesueshme të mundshme, ta përmbyste vullnetin e qytetarëve të Prishtinës, duke kapur ndërmarrjet publike të kryeqytetit. Kjo tentativë e trishtë e tyre kishte dështuar pa nisur mirë, ndonëse përballë na shpërfaqeshin grupet kriminale më të çuditshme. Se si ishin bërë bashkë të gjithë kundër shumicës sonë, ishte sa dëshpërim për nivelin politik në vend, aq dhe befasi. Kishte një interes që nuk e kuptonim dot atëherë. Synim asokohe, ndër të tjera, ishte marrja e Stacionit të Autobusëve të kryeqytetit. Sot, teksa një asamblist i tyre është arrestuar me plot 11 mijë doza narkotikësh në vlerë prej gjysmë milioni euro, si pjesë e një rrjeti që me linjat e autobusëve Prishtinë - Tiranë bartnin narkotikë në vazhdimësi; nuk ka se si të mos rikujtojmë insistimin e opozitës së kryeqytetit, Lëvizjes Vetëvendosje, për ta vendosur të njëjtin asamblist pikërisht si aksionar në këtë stacion", ka theksuar Abdixhiku, duke shtuar se pazaret e tilla duket se kanë pasur një qëllim më të thellë. "Ftoj Prokurorinë e Shtetit të hetojë këtë rrjet, në veçanti njerëzit e përfshirë në këtë skemë dhe mbështetjen politike që kanë marrë në gjithë këtë proces", ka shkruar Abdixhiku në "Facebook".

AAK-ja pas arrestimit të asamblistit të LV-së: Kurti i ka ardhur fundi

"Qeverisë Kurti nuk do t'i ndihmojë as arroganca e numrave e as kauzat e rrejshme për të shpëtuar nga ndëshkimi popullor", ka nisur postimin në "Facebook" drejtori për Informim në AAK, Lulëzim Blaka. Duke reaguar për arrestimin e asamblistit të LV-së Mujeci, Blaka ka shtuar se i njëjti "dyskohet se drogën në vlerë 400 mijë euro e ka dërguar nga Kosova në Shqipëri pikërisht me autobusë". Mes të tjerash, Blaka ka theksuar se LV-në nga ndëshkimi popullor nuk mund ta shpëtojë kauzat e rrejshme, duke bërë me dije se asamblisti i arrestuar për drogë ka qenë i zëshëm për "bashkimin kombëtar", e duke shtuar se më të pandershmët kanë dalë të jenë pikërisht më të zëshmit e LV-së. "Një pushteti që i thellohen kaq shumë skandalet, i ka ardhur fundi. Fund i turpshëm për kryemashtuesin Kurti dhe ushtrinë e tij të mashtuesve", ka shkruar Blaka.



Abdixhiku: Ftoj Prokurorinë e Shtetit ta hetojë këtë rrjet

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka reaguar pas raportimeve se asamblisti i Vetëvendosjes në Prishtinë, Besnik Mujeci, është arrestuar bashkë me disa persona të tjerë, pasi u kapën me ekstazi në Tiranë. Ai e ka ftuar Prokurorinë e Shtetit të hetojë



PRESIDENTJA E KOSOVËS, VJOSA OSMANI, VIZITON KOMUNËN E DRAGASHIT

Osmani: Kosova po e respekton marrëveshjen e Bratislavës, masat e BE-së dëmtojnë dialogun

Shefja e shtetit, Vjosa Osmani, ka thënë se Kosova është duke e zbatuar marrëveshjen e Bratislavës për shtensionimin e situatës në veri të vendit. Osmani gjatë qëndrimit në Dragash ka thënë se masat e BE-së kundër Kosovës janë duke e dëmtuar dialogun për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë. Ajo ka thënë se këto masa padrejtësisht janë vendosur ndaj Kosovës si rezultat i një fushate masive dezinformuese. Pavarësisht prej kësaj, Osmani ka thënë se është duke u krijuar baza ligjore për mbajtjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme në katër komunat në veri të Kosovës

EPOKA E RE

Lirim GECI

DRAGASH, 15 GUSHT - Presidentja Vjosa Osmani ka thënë se Republika e Kosovës është duke e zbatuar me besnikëri marrëveshjen e Bratislavës, sipas së cilës, janë shkurtuar forcat policore në dhe përreth objekteve komunale në komunat veriore. Osmani ka thënë se është duke u krijuar edhe baza ligjore për mbajtjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme në këto komuna. Megjithatë, shefja e shtetit është shprehur e habitur për masat e Bashkimit Evropian (BE) ndaj Kosovës, të cilat i ka quajtur në disproporcion me veprimet e institucioneve të Kosovës.

Madje ajo ka theksuar se masat nuk janë përgjigje që nxitin bashkëpunimin por që, sipas saj,

më së shumti i bëjnë dëm procesit të dialogut. "Pavarësisht asaj që ka ndodhur më 26 maj, vlerësoj se përgjigja e BE-së nëpërmjet masave që ka miratuar ka qenë komplet disproporcionale me veprimet e institucioneve të Kosovës. Nuk është përgjigje që nxit bashkëpunimin, përkundrazi është përgjigje e cila më së shumti i bën dëm procesit të dialogut që e qet komplet jashtë binarëve, ku të dyja palët do të duhej të trajtoheshin në mënyrë të barabartë. Serbia ka pasur njerëz të saj që kanë sulmuar ushtarët e NATO-s. Për këta njerëz ka dëshmi të sakta. Ata njerëz janë në video, dihet kush janë, disa prej tyre janë policë të Serbisë dhe nuk ka asnjë masë të vetme në raport me Serbinë për këtë agresion që ka kryer në

raport me Kosovën dhe për dhunën që ka kryer në raport me NATO-n", ka thënë Osmani pas vizitës në komunën e Dragashit. Më tutje, Osmani ka thënë se masat e BE-së padrejtësisht janë vendosur ndaj Kosovës si rezultat i fushatës dezinformuese masive kundër Kosovës. "Komunikimi im është i përditshëm me shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Sa iu përket masave që padrejtësisht janë vendosur ndaj Kosovës, unë do të thosha edhe i një fushate dezinformuese masive kundër Kosovës, e cila ka rezultuar me një sërë masash të cilat ende janë në fuqi", është shprehur Osmani. Gjatë qëndrimit në Dragash, Osmani ka folur edhe për marrëveshjen e Bratislavës që, sipas saj, është duke u krijuar baza ligjore për zgjedhje të jashtëzakonshme në katër

komunat veriore. "Në Bratislavë është arritur një marrëveshje që ka kërkuar masa të deeskalimit nga Kosova. Vendi ynë është duke e respektuar me besnikëri atë marrëveshje. Tashmë ka reduktim të forcave policore në përputhje me marrëveshjen që kërkon konsultim edhe me EULEX-in dhe me praninë e NATO-s këtu. Në anën tjetër, është duke u krijuar baza ligjore për zgjedhje të jashtëzakonshme në katër komunat veriore. Të gjitha këto kanë qenë kërkesa të marrëveshjes së Bratislavës. Tani presim që hapat t'i ndërmarrin partnerët tanë në Bashkimin Evropian, sepse masat e tyre kanë qenë komplet disproporcionale me çfarëdo pakënaqësie që mund të kenë pasur në raport me veprimet e Qeverisë së Kosovës", ka thënë Osmani.

Në këtë kontekst, ajo ka thënë se përshtypja e saj është që në ditët kur kishte tensione në veri, shumë shtete e kanë trajtuar Kosovën sikur Kosova ta ketë pushtuar dikë. Sipas saj, Kosova nuk ka pushtuar asnjë territor. "Përshtypja ime është nganjëherë shumë shtete e kanë trajtuar Kosovën ato ditë sikur Kosova ta ketë pushtuar dikë. Kosova nuk e ka pushtuar asnjë territor të shtetit fqinj. Kosova ka

vepruar në territorin e Republikës së saj sovranë, e cila është njohur nga shumica e shteteve të Bashkimit Evropian. Si presidente e vendit kërkoj që të ketë çdo ditë koordinim me aleatët dhe partnerët tanë, sepse çështjet e sigurisë janë tema kolektive, nuk janë tema individuale", ka thënë Osmani. Shefja e shtetit ka përsëritur thirrjen e saj që komuniteti ndërkombëtar të bëjë presion ndaj presidentit serb Aleksandër Vuçiq që ta ndalë presionin ndaj serbëve të Kosovës, dhe dhunën që përdoret nga strukturat ilegale në veri. "Unë jam e bindur që qytetarët dëshirojnë ta shfrytëzojnë këtë të drejtë, dhe për këtë jam e bindur nga komunikimet që kemi çdo ditë. Ata dëshirojnë të shfrytëzojnë këtë të drejtë në mënyrë që të kenë zgjedhje të jashtëzakonshme dhe t'i zgjedhin kryetarët e komunave që e marrin votën e qytetarëve në zgjedhje të lira e demokratike. Mirëpo deri më tani unë nuk shoh ndonjë vullnet nga presidenti Vuçiq, që ta ndërpresë agresionin institucional që vazhdimisht e kryen në raport me fqinjët. Nuk pres që ai ta ndërpresë dhunën që nëpërmjet strukturave kriminale

Konjufca takohet me senatoren Fernandez: Nju-Jorku, simbol i raporteve historike Kosovë - ShBA

PRISHTINË, 15 GUSHT (ER) - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Glauk Konjufca, ka pritur në takim senatoren e shtetit të Nju-Jorkut, Nathalia Fernandez. Duke i uruar mirëseardhje në Republikën e Kosovës, kryetari Konjufca e ka njoftuar senatoren Fernandez për kontributin e pakrahueshëm të Shteteve të Bashkuara dhe

shtetit të Nju-Jorkut ndaj vendit tonë, si dhe për meritat e Senatit dhe Kongresit Amerikan për shtimin e bashkëpunimit dhe forcimin e marrëdhënieve ndërmjet shteteve tona. Konjufca ka shprehur mirënjohje për punën e jashtëzakonshme ndër vite me komunitetin e gjerë shqiptaro-amerikan në Nju-

Jork, komunitetin që, siç ka thënë ai, është simboli më i mirë i raporteve të ngushta historike mes popujve tanë, interesave dhe synimeve tona të përbashkëta. Fokus i bisedës ishin marrëdhëniet e shkëlqyera midis dy vendeve mike dhe aleate, si pikënisje nga ku merret kahe vazhdimësi dhe thellimi i mëtejme i raporteve miqësore.



Kamberi: Kushtetuta na lejon të bashkëpunojmë me Kosovën, Vuçiqi po tenton të na paraqesë si destabilizues

Preshevë, 15 gusht (ER) - Deputeti i vetëm shqiptar në Kuvendin e Serbisë, Shaip Kamberi, ka thënë se bashkëpunimin e shqiptarëve të Luginës së Preshevës me Qeverinë e Kosovës, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, është duke e paraqitur si tentativë për destabilizim dhe "krijim të Shqipërisë së Madhe". "Ka disa herë që presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, bashkëpunimin tonë institucional me Qeverinë e Republikës së Kosovës e paraqet si tentativë për destabilizim dhe 'krijim të Shqipërisë së Madhe'", ka shkruar Kamberi në "Facebook".

Si një ndër të drejtat fundamentale të pakicave, sipas tij, Kushtetuta e Serbisë e parasheh edhe "bashkëpunimin me shtetin amë". Në këtë kontekst, ai ka pyetur se pse e pengon kjo Vuçiqin dhe deklarohet kundër normës fundamentale kushtetuese. "Duke pasur parasysh këtë, afërsinë gjeografike, lidhjet e përditshme e tradicionale, sidomos ato institucionale me Republikën e Kosovës, janë parakusht i avancimit të pozitës



dhe mirëqenies së shqiptarëve në Luginë të Preshevës. Pse për presidentin e Serbisë qenkan destabilizuese marrëdhëniet tona normale me Kosovën, ndërkohë që, sipas tij, janë konstruktive aventurat e tij në çdo cep të Ballkanit Perëndimor ku jetojnë serbët?", ka shkruar Kamberi. Sipas tij, "është krejtësisht normale t'i takojë liderët serbë të Kosovës në Rashkë, sa herë që e sheh të arsyeshme". "Është normale që me tona nacionaliste nëpër tubimet e tij përkrahëse në Beograd masës t'i drejtohen liderë radikalë serbë nga rajoni, përfshi këtu Knezevicin e Malit të

Zi. Është normale që ai bashkë me Dodikun e Srpskas të realizojë takime trepalëshe me patriarkun serb për të ardhmen e 'Botës serbe'. Është normale ta kërcënojë ekzistencën e Bosnjës si shtet unitar e të shfaqë ambicie destabilizuese në Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut e në Kosovë. Madje, sipas tij, është normale që me fluturaket ushtarake serbe fshehurazi të disponojë Dodikun sa herë të ketë nevojë", ka shkruar deputeti shqiptar në Kuvendin e Serbisë.

Ai ka thënë se sipas logjikës së presidentit serb, "vetëm serbët duhet ta kenë këtë të drejtë. Të tjerëve kjo e drejtë, kur tentojnë ta

materializojnë, jo vetëm që u mohohet, por tentohen në vazhdimësi të satanizohen". Sipas Kamberit, kjo logjikë e ka mbështetjen në mitin mesjetar teksa ka theksuar "se serbët janë popull hyjnor - qendra e Ballkanit - ndërsa të tjerët, në periferi, janë barbarë". "E pakuptimë dhe e papranueshme. Një logjikë të tillë nuk mund të na imponojë autokraci në krye të shtetit. E di, sipas tij, ne nuk do të duhej ta ndërlihdhim fatin tonë me Kosovën. E as kërkesat tona për reciprocitet me të drejtat e serbëve në Kosovë nuk do të duhej të jenë agjendë e bisedimeve. Kjo e frikëson

presidentin serb e për këtë ai po na sulmon vazhdimisht, por edhe ai duhet ta dijë që angazhimi ynë politik asnjëherë nuk ka pasur për qëllim destabilizimin", ka shkruar Kamberi.

Më tutje, ai ka theksuar se gjithmonë ka këmbëngulur në avancimin e pozitës së shqiptarëve dhe realizimin e të drejtave fundamentale të tyre. "Serbia ka qenë dhe po vazhdon të jetë ajo që po refuzon kërkesat tona legjitime për drejtësi, barazi, liri. Të drejtat janë universale. Ato nuk janë mëshirë e shtetit. Njeriu i fiton me lindje. Së paku kështu e thonë teoritë moderne për të drejtat e njeriut. Prandaj nuk mund të ketë drejtësi dhe paqe afatgjatë në këtë rajon të brishtë duke tentuar të krijohen pakicat apo popujt hyjnorë. Evropa dhe Ballkani e kanë provuar këtë disa herë dhe përfundimi kanë qenë luftërat e përgjakshme. Në vend të kriminalizimit të kërkesave tona legjitime, shmangies së përgjegjësisë nga tri marrëveshjet e nënshkruara, është koha të reflektosh në realizimin e obligimeve të marra. Të nënshkruara janë. Të kursejmë nga 'dhimbja e dorës së djathtë'", ka shkruar Kamberi.

vazhdimisht e ushtrojnë ndaj qytetarëve tanë në veri. Prandaj presioni duhet të jetë në Beograd, që të fillojë të sillet në përputhje me standardet evropiane e jo si një shërbëtor besnik i Putinit dhe vetëm i Putinit", ka thënë ajo.

Ndërsa kryetari i Dragashit, Bexhet Xheladini, ka kërkuar nga presidentja Vjosa Osmani ta shfrytëzojë autoritetin e saj për të çuar përpara disa projekte të cilat janë jetike për qytetarët e kësaj komune. "Kërkesa e parë ka qenë granti i katërt i financimit të komunave. Nuk është vetëm kërkesë e komunës sonë, por edhe kërkesë e të gjitha komunave të tjera. Ky grant do t'i barazojë komunat e Kosovës sa i përket financimit. Gjithashtu, ju e dini se ne kemi një projekt shumë madhor, projektin e ujësjellësit, të cilin e kemi filluar dhe i cili do të kushtojë mbi 4 milionë euro dhe me buxhetin tonë këtë projekt nuk do ta mund të përfundojmë dhe kërkojmë nga Qeveria e

Osmani për vizitën e Kurtit në Maqedoninë e Vogël: Keqkuptim i vogël

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, sërish i ka dalë në mbrojtje kryeministrit Albin Kurti pas kritikave për vizitën në Maqedoninë e Veriut. Osmani ka thënë se bëhet fjalë për një keqkuptim. "Lëvizje e një qytetari dhe jo diçka e organizuar. Në tubime askush nga organizatorët nuk e kontrollon çdo qytetar se çka ka në dorë, por ky është si parim. Natyrisht, nëse institucionet e Maqedonisë së Veriut kanë ndonjë shqetësim, e vetmja kërkesë e jona si

institucione të Republikës të Kosovës është që gjithçka të bëhet në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, standardet më të larta ndërkombëtare të mbrojtjes së komuniteteve joshumicë, dhe duke respektuar gjithmonë rolin shtetformues që komuniteti shqiptar ka pasur në ndërtimin e shtetit të Maqedonisë së Veriut dhe këtë rol të jashtëzakonshëm vazhdon ta luajë edhe sot, dhe këtë e dinë institucionet e

Kosovës dhe kërkojmë që presidentja jonë të ndikojë që edhe qeveria të subvencionojë këtë projekt. Gjithashtu, e përmenda parkun nacional i cili

është bërë pengesë për zhvillimin ekonomik të komunës. Me AKP-në që 15 vjet jemi në gjykatë. Lënda është në gjykatë dhe pret epilogun e saj.



Maqedonisë së Veriut. Ky besoj se është një keqkuptim i vogël, që kur kemi vullnet të dyja palët, siç e kemi dëshmuar gjithnjë, tejkalohet, duke e ditur që të gjitha institucionet e Kosovës janë të interesuara vetëm për relacione

pozitive gjithnjë në rritje me Maqedoninë e Veriut", ka thënë Osmani.

Vizita e Kurtit në Tetovë ka nxitur shumë reagime, duke përfshirë edhe presidentin Stive Pendarovski.

Gjithashtu, presidentes ia përmenda edhe rrugën e Brodit e cila që tri vjet e ka bllokuar qarkullimin e njerëzve, të mallrave, pasurisë dhe

zhvillimin e turizmit në atë pjesë dhe kompanisë - qendrës turistike 'Arxhena' - i ka shkaktuar humbje të mëdha", ka thënë Xheladini.

Kthimi në shkolla në veri vihet në pikëpyetje



PRISHTINË, 15 GUSHT - Dy javë para nisjes së vitit të ri shkollor, prindërit në komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës nuk e dinë nëse fëmijët e tyre do të ulen në bankat shkollore ose do t'i ndjekin mësimet online. Ata e kanë vlerësuar situatën si "komplekse", duke thënë se ende janë në pritje të udhëzimeve nga autoritetet. Institucionet arsimore në komunitetin serb në Kosovë punojnë sipas sistemit të Serbisë. Mësimi në katër komunat në veri të Kosovës, Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq ishte ndërprerë në fund të majit, kur patën rritur tensionet pasi kryetarët e rinj shqiptarë të komunave hynë në ndërtesat komunale me asistimin e Policisë së Kosovës. Institucionet përgjegjëse serbe për arsim nuk u janë përgjigjur pyetjeve të "Radios Evropa e

Lirë" lidhur me shqetësimet e prindërve për pasigurinë rreth fillimit të vitit të ri shkollor.

Cilat janë shqetësimet e prindërve?

Marina nga Leposaviq ka një djalë që më 1 shtator duhet ta fillojë klasën e parë. Ajo është shprehur e shqetësuar që në vend se djali i saj të shkojë në shkollë, ai do ta takojë mësuesen dhe shokët e tij përmes kompjuterit. "Jam shumë e shqetësuar, nuk është aspak e qartë se si ai (djali i saj) do të mësojë materialet mësimore nga interneti. Vërtetë nuk e di se çfarë do të ndodhë", ka thënë Marina për "Radion Evropa e Lirë".

Megjithatë, Marija nga Leposaviq shpreson që fëmijët të nisnin vitin e ri shkollor në shkolla. "Unë kam tre fëmijë që shkojnë në shkollë, shumica e

mësimi të tyre ka qenë online ose nuk kanë shkuar fare në shkollë. Nuk e dimë se çfarë do të ndodhë", ka thënë ajo.

Edhe Dragani nga Mitrovica e Veriut nuk e përkrah idenë që fëmijët të mos shkojnë në shkollë nga 1 shtatori, por ka theksuar se është i shqetësuar për praninë e madhe të policisë dhe për pasigurinë, sa i përket situatës së sigurisë.

"Sa i përket këndvështrimit të prindërve, askujt nuk i intereson se kur fëmijët e tyre duhet të shkojnë në shkollë", ka thënë ai.

Maja nga Zveçani ka theksuar se fëmijët duhet të shkojnë në shkollë, por vetëm nëse njësitë speciale të Policisë së Kosovës tërhiqen nga veriu. "Kam një fëmijë që do të nisë vitin e parë në gjimnaz, imagjinojeni ta nisë online. Unë kam tre fëmijë që shkojnë në shkollë, nuk mund t'iu përkushtohem të gjithëve.

Andaj mendoj se më së miri do të ishte që policia të tërhiqej dhe fëmijët të shkonin në shkollë", ka thënë Maja për "Radion Evropa e Lirë".

Pse është i pasigurt fillimi i vitit të ri shkollor?

Nisja e mësimi në shkollat në veri të Kosovës më 1 shtator është e pasigurt, pasi në Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, institucionet arsimore janë të vendosura afër objekteve komunale, ku ndodhet edhe Policia e Kosovës. Përballë janë edhe pjesëtarët e KFOR-it - misionit paqeruajtës të NATO-s në Kosovë - të cilët kujdesen për sigurinë në veri që nga fundi i muajit maj.

Serbët në veri të Kosovës kanë bojkotuar zgjedhjet lokale në prill, në të cilat janë zgjedhur kryetarët e rinj shqiptarë. Kryetarët e rinj nuk janë duke u

pranuar nga popullata lokale, të cilët prej fundit të majit janë duke protestuar para objekteve komunale në Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok.

Tensionet janë përshkallëzuar më 29 maj në Zveçan, kur serbët ishin përleshur me pjesëtarët e KFOR-it. Në atë rast kishte dhjetëra të lënduar nga të dyja palët.

Një nga arsyt e protestave të përditshme është fakti se deri më tani në ato objekte kanë funksionuar komunat paralele serbe. Vetëm në Mitrovicë të Veriut ka një ndërtesë të posaçme komunale që funksionon në bazë të sistemit të Kosovës dhe për këtë arsye atje nuk ka pasur protesta.

Përveç në muajin maj, mësimi në komunat në veri të Kosovës ishte ndërprerë edhe më 12 dhjetor të vitit 2022 për shkak të "situatës së përqesuar të sigurisë".

Ndërprerja ishte bërë pasi dy ditë më herët ishte arrestuar ish-polic i Kosovës, Dejan Pantiq. Arrestimi i Pantiqit kishte nxitur serbët të ngrinin barrikada në të cilat morën pjesë kryesisht punonjësit e institucioneve serbe, përfshirë edhe ata të arsimit. Nga barrikatadat, profesorët mbajtën mësim online për gjimnazistët. Gjithashtu, nxënësit dhe mësimmësuesit e shkollave në veri kanë marrë pjesë në protestat e fundit para komunave në Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok. Ata përmes performancave të ndryshme kanë bërë thirrje për uljen e tensioneve.

"REL"-i i është drejtuar Ministrisë së Arsimit në Qeverinë e Serbisë, e cila është përgjegjëse për institucionet arsimore në komunat me shumicë serbe në Kosovë. Kjo ministri është pyetur se nga çfarë varet fillimi i vitit të ri shkollor në veri dhe pse prindërit ende nuk janë informuar.

As nga Ministria serbe e Arsimit e as Departamenti për Edukim për Kosovën në këtë institucion nuk u janë përgjigjur pyetjeve të "REL"-it.

Viti i ri shkollor fillon më 1 shtator

Prishtinë, 15 gusht - Ministrja e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Arbërie Nagavci, ka konfirmuar se viti i ri shkollor do të fillojë më 1 shtator. Ministrja Nagavci ka thënë se tashmë kanë finalizuar kalendarin e vitit të ri shkollor 2023/24. "Kemi finalizuar kalendarin vitit të ri shkollor 2023/24. Sipas udhëzimit administrative, viti i ri shkollor fillon më 1 shtator. Risi është se do të kemi edhe pushimi vjeshtor,

në mënyrë që të kemi balancim mes ngarkesës së fëmijëve gjatë gjithë vitit të ri shkollor", ka deklaruar Nagavci.

Ndërsa për tekstet shkollore, Nagavci, ka thënë se gjatë kësaj jave do të japin detaje lidhur me furnizimin e shkollave me tekste shkollore, teksa shtoi se tekstet duhet të jenë cilësore. Në konferencën e thirrur për medie, Nagavci ka thënë se tashmë kanë ndarë mjetet për blerjen e teksteve

shkollore për nxënësit në Luginë. Po ashtu, ajo ka folur edhe për ndërtimin e disa çerdheve. "Ndërtimi i çerdheve ka qenë një nga premtimet tona, në kuadër të kësaj ne kemi nënshkruar javën e kaluar edhe kontratën për ndërtimin e një çerdhe në Fushë Kosovë, presim që gjatë javës së ardhshme të fillojë ndërtimi i saj, dhe jemi në proces edhe për ndërtimin e çerdheve në Batllavë dhe Shtime", ka thënë ministrja Nagavci.



Reparti për IVF në QKUK pret pajisjet për funksionalizim

PRISHTINË, 15 GUSHT - Zana nga Prishtina (identiteti i vërtetë i së cilës është i njohur për redaksinë) ka thënë se dëshiron t'i nënshtrohet metodës së fertilitetit të asistuar mjekësor (IVF), por kjo procedurë ende nuk ofrohet në institucionet shtetërore mjekësore. Nga Ministria e Shëndetësisë (MSh) kanë premtuar se deri në fund të vitit ky shërbim do të ofrohet për qytetarët.

Për shkak të mungesës së ligjit adekuat, kjo procedurë ofrohet vetëm në institucionet shëndetësore private të licencuara. Fertilizimi me IVF kushton mijëra euro dhe vetëm çiftet e martuara në Kosovë mund t'i nënshtrohen kësaj metode. "Në fund të vitit jam interesuar për metodën e fertilizimit të asistuar mjekësor në Kosovë dhe nuk kam pasur mundësi ta kryej këtë shërbim për shkak të pagesave shumë të larta në spitalet private", ka thënë Zana për "Radion Evropa e Lirë". Ajo ka treguar se kjo procedurë ofrohet edhe jashtë shtetit, por shumica është shumë e lartë për të. "Kostoja sillet duke nisur nga 4 000 euro e më lart. Kjo vlerë është e papërbalueshme, vetëm përmes kredive dhe më është dukur shpenzim marramendës, duke pasur për bazë rrogat që janë në Kosovë", ka thënë Zana. Ajo shpreson që në një të ardhme, këtë procedurë shteti ta ofrojë falas për personat që duan të bëhen prindër. "Shpresoj që shteti i Kosovës të lejojë pikë së pari ligjërisht vajzat beqare që të mund të bëhen nëna, në pamundësi për të gjetur një partner dhe për gratë që nuk mund të bëjnë fëmijë, shteti t'ua ofrojë këtë shërbim (IVF) dhe jo të detyrohen të shkojnë në shtetet fqinje apo edhe më larg", ka thënë ajo.

Çfarë është IVF?

IVF-ja është një metodë fertiliteti, së cilës i nënshtrohen personat që nuk mund të lindin fëmijë në mënyrë natyrale.



Përmes kësaj procedure ekipi mjekësor heq vezët nga vezoret e një gruaje dhe më pas i fekondon ato me spermë në laborator. Embrioni të fekunduar i jepen disa ditë për t'u rritur dhe më pas ai vendoset në mitrën e gruas. Procesi zakonisht zgjat katër deri në gjashtë javë. Por, as kjo metodë nuk është 100 për qind e suksesshme.

Në pritje të pajisjeve për IVF

Kosova synon të ketë një repart të posaçëm për IVF në Qendrën Klinike Universitare (QKUK). Për pajisjet e nevojshme për këtë repart, Ministria e Shëndetësisë ka ndarë 1.5 milion euro. Në Klinikën e Gjinekologjisë, në kuadër të së cilës do të jetë repart i IVF-it, po presin pajisjet për këtë metodë mjekësore. Punimet në infrastrukturë për repartin e ri veçse janë kryer. Drejtori i Gjinekologjisë, Zef Ndrejaj, ka thënë se kur të kryhen përgatitjet dhe të vijnë pajisjet, personeli i Klinikës është i gatshëm për punë. "Sa i takon çështjes së personelit

profesional, trajnimeve e gjithçka tjetër, ne jemi të gatshëm ta nisim punën menjëherë në momentin që t'i kemi pajisjet. Me sa e dimë, sa i përket çështjes së pajisjeve, procesi është në tenderim dhe kur të përfundojnë procedurat, besojmë se do ta nisim punën", ka thënë ai.

Ndërtimi i repartit për IVF kishte nisur tri vjet më parë dhe drejtuesit e atëhershëm të QKUK-së ishin zotuar se ky shërbim do të niste më 2021. Por, ministri i Shëndetësisë (MSh), Arben Vitia, ka thënë se deri në fund të këtij viti pritet të përfundojnë të gjitha punët dhe qytetarët do të mund t'i marrin shërbimet e nevojshme në këtë repart. "Procedurat janë duke shkuar sipas planit. Natyrisht, këto janë procedura të prokurimit dhe ne nuk kemi mundësi as t'i shtyjme e as t'i bëjmë më shpejt ose më ngadalë, sepse janë procedura që e kanë rrjedhën e vet. Për momentin, punët janë duke shkuar sipas planit dhe nëse do të ketë vonesa, ato do të jenë nga prokurimi, mirëpo ne i kemi marrë të gjitha masat që të mos

ketë vonesa", ka thënë Vitia.

Kundërshtime për Ligjin e ri të shëndetësisë

Institucionet private shëndetësore aktualisht e kryejnë metodën e IVF-it bazuar në Ligjin për Shëndetësi dhe në bazë të një udhëzimi administrativ të MSh-së. Por, ligji dhe ky udhëzim administrativ nuk ua mundësojnë grave beqare që t'i nënshtrohen metodës së IVF-it. Qeveria e Kosovës i ka dërguar Kuvendit për miratim Ligjin e ri për Shëndetësi, ku lejohet që një grua e pamartuar të lindë fëmijë përmes metodës IVF. Por, deputetët nuk e kanë miratuar atë. Në nenin 15 të ligjit thuhet se të drejtën e shfrytëzimit të metodës IVF ka personi i moshës madhore në bashkësi martesore ose jashtëmartesore, i cili, sipas gjendjes së përgjithshme shëndetësore, është i aftë për punë dhe për përkujdesje prindërore. Sipas ligjit, të drejtën e shfrytëzimit të IVF-it e kanë edhe gratë e pamartuara, mbi 18 vjeç, që janë në gjendje të mirë

shëndetësore e sociale dhe janë të afta "për fertilizim dhe për përkujdesje prindërore". Kjo pjesë e legjislacionit është kundërshtuar nga disa deputetë. Në mesin e tyre është edhe kryetarja e Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Duda Balje.

Balje ka thënë se Kosova nuk është e gatshme të ofrojë shërbime të tilla për gratë beqare. "Asnjë nga deputetët nuk jemi kundër [metodës] IVF për çiftet. IVF-ja është duke u bërë në Kosovë në klinika private, por kemi një pikë të diskutueshme që gratë vetë të bëjnë IVF, pa pasur burra. Ne mendojmë se ende nuk jemi gati për këtë për disa arsye. Personalisht mendoj se nëse një grua lind një fëmijë pa prind, ajo e lind një fëmijë jetim dhe, po ashtu, kjo është në kundërshtim me të drejtat e fëmijëve. (Nëse fëmija nuk i ka të dy prindërit) mendoj se është problem", ka thënë Balje.

Por, Avokati i Popullit, Naim Qelaj, mendon krejt ndryshe. Ai ka thënë se është në kundërshtim me të drejtat e njeriut nëse një gruaje të pamartuar i ndalohet që të ketë fëmijë përmes IVF-it. Sipas tij, çështja e metodës IVF duhet të rregullohet me ligj e jo vetëm përmes udhëzimeve administrative. "Unë konsideroj se çdo kufizim dhe cenim i kësaj të drejte është shkelje e të drejtave të njeriut. Kështu që për mua detyrimisht duhet të lejohet dhe rregullohet me ligj", ka thënë Qelaj.

Ministri Vitia ka thënë se ekzekutivi nuk do të ndalet deri në miratimin e ligjit, të cilin ai e cilëson shumë të rëndësishëm. Vitia pret që Ligji për Shëndetësi të miratohet në Kuvend gjatë sesionit të vjeshtës. Sipas një raportit të publikuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) në prill të këtij viti, një në gjashtë persona në botë përballet me probleme steriliteti. Sipas kësaj, i bie që 16 për qind e popullatës botërore përballet me këtë problem.

Kurti takon ekipin udhëheqës të gërmimeve në lokalitetin arkeologjik "Ulpiana"

PRISHTINË, 15 GUSHT (ER) - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe ministri i Kulturës, Hajrulla Çeku, ka pritur në takim ekipin udhëheqës të gërmimeve në lokalitetin arkeologjik "Ulpiana". Sipas njoftimit të zyrës së kryeministrit, Kurti ka pritur në takim Christophe Goddard nga Universiteti "Ecole Normale Supérieure" në Paris, Arben Hajdarin, profesor në Universitetin e Prishtinës dhe Milot Berishën, arkeolog në Institutin Arkeologjik të Kosovës. Me këtë rast, Kurti i

ka falënderuar ata për punën dhe përkushtimin në projektin "Gërmimet në lokalitetin arkeologjik Ulpiana" që janë duke u zhvilluar në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Universitetit të Prishtinës dhe atij francez, "Ecole Normale Supérieure", ndërsa është informuar për punën e deritanishme dhe zbulimin e fundit me rëndësi historike në këtë lokalitet. "Në takim u theksua se mbishkrimi monumental paraqet një dëshmi shumë të

rrallë, një dedikim perandorak nga Perandori Justinian (527-565) i qytetit Justiniana Secunda, i përshkruar si qytet Dardan, në provincën e Dardanisë (krijuar nga paraardhësi i tij Diokleciani në fillim të shek. IV pas e.s) dhe kishës së tij. Zbulimi dëshmon afërsinë e perandorit me provincën e origjinës, ndërkaq Kisha paraqet një strukturë arkitektonike të klasës botërore sikurse ndërtimet e S. Sophia në Konstandinopojë dhe S. Vitale në Ravenë. Kjo kishë,



po ashtu, paraqet një prej zbulimeve më të mëdha të Perandorisë së vonshme

romake dhe perandorëve më të rëndësishëm", ka njoftuar zyra e kryeministrit.

Shala: Kosova importon thëngjill! A ka mundësi edhe kjo të ndodhë?

PRISHTINË, 15 GUSHT (ER) - Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ferat Shala, ka thënë se pavarësisht se vendi ynë është fuqi evropiane për rezervat e thëngjillit, është duke e importuar këtë produkt. Shala ka thënë se Feronikeli është duke importuar 10 mijë tonë thëngjill në muaj. Shala në "Facebook" ka pyetur institucionet e shtetit se si është e mundur që kompanitë vendore të importojnë thëngjill kur Kosova ka rezerva të mëdha të këtij resursi natyror.



"Në këto ditë pushimi, qeveria nuk po stabilizohet assesi. Sot nuk po i numëroj aferat politike e as ato ekonomike, si ato në sektorin e energjisë, rezervat shtetërore të grurit, vajit etj. Por sot po ngris shqetësimin ekonomik e logjik.

Kosova është fuqi evropiane e botërore me rezervat e thëngjillit, mbi 12 miliard ton lignite në tri basenet: Ai i rrafshit të Kosovës, ai i rrafshit të Dukagjinit dhe ai i rrafshit të Drenicës. E fatkeqësisht, Feronikeli sot importon 10 000 (dhjetë mijë) ton thëngjill në muaj nga Mali i Zi, për nevoja industriale të saj. Krejt kjo çmenduri ekonomike e Qeverisë, përkatësisht Ministrisë së Ekonomisë e cila udhëheqë dhe menaxhon ndërmarrjen publike KEK", ka shkruar Shala, duke shtuar se

përgjigjet për pyetjet e mëposhtme i di vetëm kryeministri Albin Kurti. "Pse Feronikeli importon thëngjill, e KEK-u nuk e furnizon me atë? Pse po ndodh e gjithë kjo? Pse Feronikeli është pak kilometra nga KEK-u? Pse Feronikeli punëson mbi 800 punëtorë në linjë direkte, e mbi 1 500 indirekte? Pse Feronikeli është në Drenas? Apo pse Feronikeli është ndërmarrje private dhe investitori i jashtëm? Këto përgjigje i di vetëm kryeministri Kurti", ka shkruar Shala.

"100 mijë euro për një muaj", Kurti kritikohet për numrin e lartë të këshilltarëve

Numri i lartë i këshilltarëve të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, ka nxitur reagime të shumta në rrjetet sociale. Sipas raportimeve në medie, Kurti numëron 38 këshilltarë politikë, por që një gjë e tillë është mohuar nga zëdhënësi i qeverisë, Përparim Kryeziu, i cili ka thënë se kryeministri ka 25 këshilltarë. Ky numër i "tmerruar" analistët e zhvillimeve politike, pasi Kurti dikur sa ishte në opozitë thoshte se ndoshta nuk i duhen më shumë se pesë këshilltarë. Opinionisti Petrit Zogaj e ka kritikuar kryeministrin Albin Kurti për numrin e lartë të këshilltarëve. Zogaj në "Facebook" ka shkruar se Kurti e ka shumë problem që të ketë mirëkuptim brenda 38 këshilltarëve për t'i prishur raportet me tri shtetet fqinje. "Është goxha problem me arrit konsensus brenda 38 këshilltarëve që Kurti i paska, që me i prishë raportet me tre shtetet kufitare me Kosovën. Sa letra duhesh shkruar, sa analiza duhet bërë e sa takimet duhet me u planifikuar me kryeministrin këta 38 këshilltarë politikë, që me e bindë atë që Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe



Malit të Zi, duhet me ua tregu vendin", ka shkruar Zogaj. Ndërsa analisti i politikës Ilir Mirena ka rikujtuar deklaratën e Kurtit të vitit 2019 ku thoshte se ndoshta i mjaftojnë pesë këshilltarë. Më tej, ai ka thënë se Kurti i ka mashtruar votuesit e tij. "Nuk kanë çfarë më duhen as 35 këshilltarë, jo naj pretencioziteti intelektual timin, por nashita 5 këshilltarë më mjaftojnë. 35 janë si mos të jenë asnjë, ose tregojnë një

farë paaftësie fundamentale të vetë kryeministrit...". Kështu paska deklaruar Albin Kurti në shtator të vitit 2019, asokohe për qeverinë Haradinaj. Sot 38 këshilltarë n'kajmak i paska fikalli vet. Euu bre po flliqt ju ka mashtru...", ka shkruar Mirena në "Facebook". Gjithashtu, edhe analisti tjetër Afrim Haliti ka ironizuar me numrin e lartë të këshilltarëve të Kurtit duke thënë se: "Pa i

bo 69 nuk njehet". Edhe politikanë të tjetër të opozitës e kanë kritikuar Kurtin për numrin e këshilltarëve. Deputeti i LDK-së, Driton Selmanaj, e ka quajtur Kurtin "mashtues perfid". "Mashtuesi perfid! Sa ishte në opozitë thoshte më mjaftojnë vetëm 5 këshilltarë, kurse tani në pushtet kabineti i tij numëron hiq më pak se 100 zyrtarë që e këshillojnë e ndihmojnë Albin Kurtin dhe

tre zëvendësit e tij" ka shkruar Selmanaj në "Facebook". Ai ka thënë se për një muaj këshilltarët e Kurtit i kushtojnë shtetit 100 mijë euro. "Sipas ligjit, pagat e anëtarëve të kabinetit të Kurtit sillen nga 987 deri në 1155 euro, pa llogaritur këtu edhe përfitimet e tjera që gëzojnë, si mëditjet, shpenzimet e biletave, reprezentacionit etj. Vetëm për një muaj buxhetit të shtetit i kushtojnë hiq më pak se 100 000 (njëqind mijë) euro. Kurse për një vit mbi 1.2 milion euro. Në opozitë promovonin kursim dhe kujdes ndaj parasë publike, kurse në pushtet zhvatin dhe abuzojnë çdo të mirë publike. Turpi nuk paska fund!", ka shkruar Selmanaj. Ndërsa deputetja e PDK-së, Blerta Deliu-Kodra, ka ironizuar me numrin e madh të këshilltarëve që ka angazhuar kryeministri Albin Kurti. Ajo ka shkruar në "Facebook" se i pari i qeverisë paska angazhuar për këshilltarë të gjithë ata që kanë protestuar së fundi në mbështetje të qeverisë. "Po get, kryeministri i paska marrë si këshilltarë krejt qata që dolën në 'protestën mbështetëse' për qeverinë!", ka shkruar ajo.

Pesë kompani nën hetime për marrëveshje të rritjes së çmimit të vajit


PRISHTINË, 15 GUSHT - Autoriteti i Konkurrencës ka nisur hetimin ndaj disa ndërmarrjeve për rritjen e çmimeve të disa produkteve me fokus vajin. Një gjë e tillë e ka bërë me dije ushtruesi i detyrës së drejtorit në këtë institucion, Selajdin Beqa. Ai ka theksuar se gjatë pandemisë ishin publikuar lajme alarmante për mungesë të vajit, të cilat kishin krijuar tollovi për blerje në markete. "Pas kalimit të një pandemie të

tmerrshme, sulmit të Federatës ruse mbi Ukrainën, rritjes së furnizimit dhe të transportit nëpër tregje globale, kjo ndikoi edhe në tregun e Kosovës. Mbi bazën e kësaj kemi bërë shqyrtimin paraprak dhe kemi arritur në përfundimin se duhet të hapim procedurë mbi disa premisa apo dyshime të caktuara mbi disa ndërmarrje", ka thënë Beqa për "RTK"-në. Beqa ka njoftuar se janë pesë kompani të

cilat dyshohen për marrëveshje të ndaluara, të cilat kanë fiksuar çmimin e vajit. Rasti është nën hetime nga Prokuroria e Shtetit. "Në disa raste shteti mund të ndërtojë, siç është edhe rasti te produktet bazike dhe ato të energjisë. Mirëpo sa i përket çështjes së vajit shteti s'mund të ndërtojë sepse dihet se si përcaktohen çmimet në treg, sipas parimit të ofertës dhe kërkesës", ka thënë ai.



Sa anije të mbytura ndodhen në oqeanet e botës?



Nga Zaria GORVETT

Kur Elias Stadhiatis zbriti në thellësi të detit, ai mendonte se do të kishte përpara një ditë të zakonshme kërkimi për sfungjerë. I rënduar nga një kostum zhytjeje prej bakri, dhe i rrethuar nga një lëmsh tubash që i shërbenin për frymëmarrje, Stadhiatis mbërriti pak disa momentesh në fund të detit.

Teksa po shihte në errësirë, u ndesh befas me një skenë të frikshme: përreth ishin skicat e paqarta të pjesëve të trupit të njeriut. Pasi doli në sipërfaqe me shpejtësi e informoi kapitenin e anijes se kishte gjetur një grumbull kufomash të dekompozuar. Ishte pranvera e vitit 1900, dhe Stadhiatis kishte zbuluar aksidentalisht Antikitera, një anije mallrash romake e cila ishte fundosur më shumë se 2 mijë vjet më parë. Shumë shpejt u bë e qartë se ajo nuk ishte e mbushur me kufoma, siç u duk në fillim, por me vepra arti – skulptura prej mermeri dhe statuja bronzi, që ishin dërguar për mijëra vjet mes algave, sfungjerëve dhe peshqve. Më shumë se 100 vjet më vonë, reliket e Antikiterës janë ende joshëse për publikun. Por priten të mbuloohen shumë mrekulli tjera që ndodhen ende nën det. Ekspedita e fundit është ajo e UNESCO-s në Skerki Bank, një zonë detare shkëmbore, e cekët dhe e pabesë për detarët, që lidh Mesdheun lindor dhe atë perëndimor. Ajo rrugë është përdorur për

mijëra vjet, dhe aty janë mbytur qindra anije. Duke përdorur sonarë dhe robotë nënujorë, një ekip shkencëtarësh nga 8 vende të botës hartuan fundin e detit në atë rajon. Dhe këtë javë, ata njoftuan zbulimin e 3 rrënojave të reja: mbetjet e anijeve që datojnë që në shekullin I Para Krishtit, shekullin II Pas Krishtit dhe shekujt XIX ose XX.

Dhe sipas vlerësimeve të UNESCO-s mund të ketë shumë rrënoja të tjera të pazbuluara ende nën dallgët e oqeanëve të botës. Varka më e vjetër e njohur deri më sot u zbulua aksidentalisht gjatë ndërtimit të një autostrade në Holandë: një kanoe prej druri e ndërtuar mbi 10.000 vjet më parë. Por ka prova rrethore se gjithçka filloi shumë më herët. Rreth 50.000 vjet më parë, mendohet se një grup gjuetarësh-mbledhësish nga Azia Juglindore, duhet të ketë kaluar tek një grup ishujsh qindra milje të gjatë. Menjëherë pas këtij momenti, u shfaqën aborigjenët e parë australianë në liqenin Mungo në Uellsin e Ri Jugor.

Dhe ku ka vendkalime detare, ka edhe rrënoja. Sot oqeanet e botës janë plot me mbetjet e anijeve mijëvjeçare tregtare, luftarake dhe eksploruese. Anije pirate të ngarkuara me argjend, anije mallrash që janë udhëtuar përgjatë Rrugës detare të Mëndafshit, anije mbretërore luksoze që u zhdukën së bashku me mbretërit e ardhshëm, anije të lashta peshkimi, destruktore dhe nëndetëse moderne, anije gjuetare të balenave të shekullit XIX, dhe

anije të mëdha pasagjerësh si Titaniku.

Ashtu si kapsulat e kohës të harruara prej kohësh, këto anije i kanë mahnitur arkeologët dhe kanë mbushur muzetë anembanë globit me mrekulli të lashta, përfshirë një orë misterioze astronomike nga Antikitera, të cilën disa ekspertë e shohin si kompjuterin më të hershëm.

Por sa anije mbeten ende të fshehura në thellësitë e deteve dhe oqeanëve? Ekzistojnë disa baza të dhënash mbi anijet e mbytura në botë, ku secila ka një vlerësim paksa të ndryshëm për numrin total. Kështu, një faqe përmban një katalog prej 209.640 varkash që dihet se janë fundosur, 179.110 prej të cilave kanë një vendndodhje të njohur.

Ndërkaq baza e të dhënave Global Maritime Wrecks, përmban të dhënat e më shumë se 250.000 anijeve të fundosura, megjithëse disa prej tyre nuk janë gjetur ende. Sipas një vlerësimi, rreth 15.000 anije u mbytën vetëm gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Ka jo pak luftanije dhe cisterna të harruara, të shpërndara nga Paqësori në Atlantik, nga të cilat rrjedhin gradualisht naftë, kimikate dhe metale të rënda në ujë përreth tekta ato kalben.

Në fakt, mendohet se mbytet e anijeve që janë dokumentuar, përfaqësojnë vetëm një pjesë të vogël të totalit.

Sipas një analize të UNESCO-s, në oqeanet e botës gjenden mbi 3 milionë anije dhe varka që mbeten ende të pazbuluara. Këto relike

nuk ka gjasa të jenë të shpërndara në mënyrë të barabartë. Sepse disa pika janë shndërruar në varreza detare përgjatë rrugëve më popullore ose të rrezikshme, të cilat dikur kanë qenë terrene pjellore për gjuetinë.

Këtu përfshihet edhe Skerki Bank, por edhe arkipelagu Furni, po në Mesdhe, ku deri tani janë zbuluar 58 anije të mbytura, 23 prej të cilave në vetëm 22 ditë në vitin 2015. Kjo sasi e fshehtë e rrënojave ende të pazbuluara, përmban detaje magjepsëse se si kanë jetuar dikur njerëzit si dhe rreziqe të mundshme për të ardhmen.

Por mund të përmbajë edhe pasuri marramendëse. Dhe kjo mund të jetë problematike. Rreth orës 19:00 të datës 8 qershor 1708, një shpërthim i fuqishëm u dëgjua në të gjithë Detin e Karaibeve deri në brigjet e Kolumbisë. Ai vinte nga San Jose, një anije e nisur nga Spanja 2 vite më parë.

Ajo ishte pjesë e flotës spanjolle të thesarit dhe pati një fund tragjik pas një përleshje me një anije britanike. Pas disa orë beteje, u goditën depot e saj të barutit dhe ajo u mbyt pothuajse menjëherë, duke u zhdukur në oqean së bashku me gati 600 anëtarë të ekuipazhit.

Mbi 300 vjet më vonë, në vitin 2015, marina kolumbiane gjeti më në fund mbetjet e saj, së bashku me topat, qeramikën dhe monedhat. Në total, ngarkesa e saj vlerësohet të kenë një vlerë prej 17 miliardë dollarësh. Por ky zbulim shkaktoi menjëherë një debat të ashpër se kush duhet t'i mbajë


rrënojat.

Dhe tani ka shqetësime se zona arkeologjike do të plaçkitet në vend se të mbrohet. Këto lloj mosmarrëveshjesh, mund të shndërrohen së shpejtë në dukuri shumë më të zakonshme. Në të kaluarën, shumë anije të mbytura janë gjetur në ujëra relativisht të cekëta, dhe ndonjëherë rastësisht, kur peshkatarët, shkencëtarët ose gjuetarët e thesareve eksploronin shtratin e detit përreth brigjeve.

Por me qasje tek zhytësit e sofistikuar, pajisjet moderne me kamera dhe teknologji të reja sonare, gjetja e anijeve të mbytura në thellësi të mëdha, nuk ka qenë kurrë kaq e lehtë. Tani është e mundur të ndërtohet një pamje e dyshemesë së oqeanit.

Në vitin 2019, studiuesit zbuluan vendin e prehes së destruktore "USS Johnson" në thellësinë 6 mijë metra në Hendekun Filipine. Por tani për tani, ka ende shumë rrënoja të pazbuluara në thellësi. I tillë është rasti i "Waratah", një anije gjigante pasagjerësh, shpeshherë e krahasuar me Titanikun.

Ajo u nis nga Durbani në Kejp Taun më 26 korrik 1909 me 211 pasagjerë në bord, dhe më pas u zhduk pa asgjë gjurmë. Deri më sot, askush nuk e di se çfarë ndodhi, apo ku u mbyt saktësisht kjo anije, pavarësisht të paktën 9 ekspeditave. Kush e di se çfarë do të ndodhë më pas. Vetëm një gjë është e sigurt: nuk do të kalojë shumë kohë derisa sa ta zbulojmë. / "BBC" – Bota.al



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

'Dardanët' rikthehen në aksion më 9 shtator

PRISHTINË, 15 GUSHT - Barazimet me Rumaninë dhe Andorrën, si dhe humbja nga Bjellorusia, kanë bërë që Kosovës t'i minimizohen gjasat për kualifikim në Kampionatin Evropian 2024. Këto rezultate sollën më

pastaj edhe shkarkimin e trajnerit francez Alain Giresse, vendin e të cilit e mori Primoz Gliha. Në Grupin I, Kosova është e parafundit me vetëm tri pikë pas tri barazimeve e një humbjeje, duke mbetur kështu shumë prapa liderëve

të këtij grupit, Zvicrës që ka 10 pikë dhe Rumanisë me tetë sosh. Por, deri në fund të këtyre kualifikimeve, "dardanët" do t'i zhvillojnë edhe pesë ndeshje, ndërsa e radhës është ajo kundër Zvicrës në "Fadil Vokrri", sfidë

e cila zhvillohet më 9 shtator. Pas Zvicrës, Kosova luan dy ndeshje në udhëtim kundër Rumanisë dhe Andorës, pastaj e pret në Prishtinë Izraelin dhe në fund ballafaqohet me Zvicrën në udhëtim.



Rrahmani duhet të presë ende për debutim

BUKURESH, 15 GUSHT - Sulmuesi Albion Rrahmani i është bashkuar Rapidit në Rumani që një javë, por ai ende nuk ka debutuar për këtë skuadër dhe duhet të presë ende për të bërë një gjë të tillë. Pengesë për debutimin e "Lewandowskit të Malishevës" në elitën e futbollit rumun është bërë pasaporta.

Presidenti i klubit, Daniel Niculae, ka deklaruar se procedurat për rregullimin e dokumenteve të Rrahmanit për shkak se vjen nga një shtet që nuk është anëtar i Bashkimit Evropian (Kosova) janë problemi kryesor për vonesën e debutimit të Rrahmanit. Niculae mezi pret që sulmuesi i Kosovës të debutojë sa më shpejt me skuadrën e Rapidit. "Edhe Rrahmani ka ardhur, por është nga një shtet që ndodhet jashtë BE-së. Do të kalojë pak kohë që ta shfrytëzojmë. Shpresojmë që kjo periudhë të jetë sa më e shkurtër. Për Rrahmanin po presim

dokumentet. Ju e dini mirë që i marrin kohë. Po të isha optimist do të thosha dy javë e gjysmë, po të isha pesimist do të thosha një muaj. Dua ta zgjidh sa më shpejt. Ideal do të ishte para pushimit kombëtar, por nuk dua të kemi ndonjë iluzion, shpresoj sa më shpejt, por nuk varet nga ne", ka thënë Daniel Niculae në një intervistë për "Fanatik".

Rrahmani ka fituar dy herë me radhë titullin e kampionit me Ballkanin. Ai ishte golashënuesi më i mirë edicionin e fundit, me 21 gola. Në sezonin e kaluar Albion Rrahmani ka luajtur 50 ndeshje në të gjitha garat për FC Ballkanin dhe ka arritur të shënojë gjithsej 30 gola. Rrahmani është transferuar në Superligën rumune nga skuadra e Ballkanit për një shumë prej 600 mijë eurove. Rrahmani është bërë transferimi më i shtrenjtë në histori të Superligës së Kosovës.



Vojvoda: Nuk kisha shënuar që dy vjet, trajneri ma kërkoi një gol



TORINO, 15 GUSHT - Mbrojtësi i Kosovës, Mërgim Vojvoda, ka qenë më meritori në fitoren e Torinos në Kupën e Italisë, pasi shënoi një gol dhe dhuroi një asistim ndaj ekipit FeralpiSalo (2-1). Vojvoda pas ndeshjes ka zbuluar se trajneri Ivan Juriq i bëri me dije se nuk kishte shënuar gol që dy vjet dhe ia kërkoi që ta bëjë një gjë të tillë në këtë ndeshje. "Jemi përgatitur mirë për këtë lojë që kur luajtëm me FeralpiSalo në fazën përgatitore. Kemi luajtur mirë. Që dy vjet po provoj të shënoj. Trajneri ma kujtoi që kanë kaluar dy vjet që nuk kisha shënuar. Sot ma kërkoi një gol dhe

jam i kënaqur që e realizova", ka thënë Vojvoda për "Torino Channel". Torino ndeshjen e parë në Serinë A e zhvillon kundër Cagliariarit. "Duhet ta presim një Cagliari të uritur. Do të jetë një ndeshje e vështirë. Ata janë të motivuar pasi e fituan Serinë B. Por, ne e dimë se çfarë duhet të bëjmë, do të luajmë në shtëpinë tonë, duhet të bëjmë mirë. Sot e mira është që e kemi kaluar këtë xhiro në Kupë. Do të shkojmë përpara hap pas hapi dhe do të përpiqemi të shkojmë sa më larg të jetë e mundur", ka deklaruar Vojvoda.

Shiten të gjitha biletat për ndeshjen Shqipëri - Poloni

TIRANË, 15 GUSHT - Ndonëse bileta më e lirë kushton 2 000 lekë të reja, të gjitha janë shitur për ndeshjen Shqipëri - Poloni, e cila do të luhet më 10 shtator në stadiumin "Air

Albania". Do të jenë 20 mijë tifozë për t'i mbështetur kuqezinjët në këtë sfidë, ku një fitore e mundshme do të afronte shumë kualifikimin në Evropianin e vitit të

ardhshëm. Më 7 shtator fillimisht Kombëtarja shqiptare, që ndodhet në vendin e dytë në grup, do të luajë në transfertë ndaj Çekisë së vendit të parë,

ndërsa tri ditë më vonë kundër Polonisë, që ndodhet në vendin e tretë, ndeshje që shihet vendimtare për fatet e të dy ekipeve.



Helenius: Nuk më kujtohet asgjë pas grushtit të Joshuas

LONDËR, 15 GUSHT - Robert Helenius mendon se mund të kishte mundur Anthony Joshuan nëse do të kishte më shumë njohuri rreth rivalit të tij, por ka pranuar se nuk i kujtohet fare se si ndodhi nokauti i tij përballë britanikut. Dyshja u

përplasën të shtunën mbrëma, pasi Helenius hyri si zëvendësues i Dillian Whyte dhe AJ shënoi fitoren e tij të parë me nokaut që nga viti 2020 kur mposhti Kubrat Pulev. Pas një nisjeje relativisht të lehtë të gjashtë raundeve të betejës,

Joshua lëshoi dorën e djathtë fuqishëm në mjekrën e Helenius, gjë që e la atë pa ndjenja në tokë. "Ishte një zhurmë e madhe", ka thënë Heleniusi. "Nuk e mbaj mend ndikimin. Trupi im po mbaronte në atë moment. Sigurisht që dhemb, zemra më

së shumti. Do të kisha dashur shumë ta fitoja këtë ndeshje. Do të shohim se çfarë do të vijë nga kjo", ka shtuar ai. Sa i përket Joshuas, ai ka të ngjarë të shkojë në një përplasje të madhe me Wilderin në Arabinë Saudite në fillim të vitit të ardhshëm.



Kumbulla: Kumbulla e ka besimin e Romës dhe Mourinhos

ROMË, 15 GUSHT - Marash Kumbulla përgatitet ta nisë sezonin e katërt me Romën në Serinë A, teksa aktualisht mbrojtësi i kombëtares është në fazën e fundit të rikuperimit nga një dëmtim i trashëguar prej sezonit të kaluar, saktësisht në sfidën e pesë majit ndaj Monzas. Pavarësisht prej luhatjeve, 23-vjeçari ka besimin e drejtuesve të klubit dhe trajnerit Jose Mourinho e për këtë del garant menaxheri i Kumbullës, Gianni Vitali. Ky i fundit në një intervistë për "Radio Sportiva" shprehet se pas dëmtimit e sheh futbollistin edhe më të vendosur për t'u rikthyer në versionin e tij më të mirë. "Kumbulla do ta nisë sezonin e katërt me Romën dhe aty ai ndihet mjaft mirë. Është në një vend ku ka vlerësimin e klubit, shokëve të skuadrës dhe trajnerit Jose Mourinho. Ndihet pjesë e rëndësishme e projektit dhe shoh që janë të gjitha kushtet për të vazhduar përpara. Më duhet të theksoj se pas këtij



dëmtimi e shoh Kumbullën edhe më të vendosur, të bindur dhe të përqendruar për të ardhmen. Rikuperimi po shkon në mënyrën më të mirë të mundshme falë punës së të

gjithë stafit. Të gjitha palët po bashkëpunojnë më së miri", u shpreh Vitali. Kujtojmë se Roma e nis kampionatin me datë 20 gusht teksa pret në shtëpi Salernitanën.

'L'Equipe' zbulon sakrificën e Mbappes për t'u kthyer në stërvitje me ekipin e parë të PSG-së

PARIS, 15 GUSHT - "Telenovela Mbappe" vazhdon me një kapitull të ri. Pas rikthimit në dinamikën e ekipit të parë, pas një takimi ku klubi dhe lojtari afruan pozicionet, në rendin e ditës është rinovimi i mundshëm i francezitet. PSG-ja dëshiron ta rinovojë kontratën e Mbappes dhe të shmangë në çdo mënyrë të mundshme që sulmuesi të largohet falas, pa lënë asnjë para në arkën e klubit parisien. Madje, nga Franca avancuan me lajmin se Kylian mund ta marrë në konsideratë zgjatjen e kontratës së tij. Pavarësisht prej kësaj, "L'Equipe" thekson se në takimin në mes të futbollistit dhe klubit nuk është menduar asnjëherë rinovimi i kontratës dhe Kylian Mbappe vazhdon ta mbajë qëndrimin e tij për moszgatje të marrëveshjes deri në vitin 2025. Sipas informacioneve të gazetës franceze, ylli francez mund të falë



disa para si gjest mirënjohjeje për rikthimin në radhët e ekipit të parë parisien. Vlerësohet se shuma që Mbappe do të falë nënkupton rreth 100-150 milionë euro për PSG-në. Një gjest që "L'Equipe" e përshkruan si një "sakrificë personale". Lojtari ende i PSG-së e

ka bërë të qartë në disa raste tashmë synimin e tij për të mos u larguar falas nga klubi francez. Për këtë duket se rinovimi me një klauzolë të mundshme largimi të rënë dakord do të ishte alternativa më e mirë, edhe pse për momentin duket larg arritjes.

SHKURT

Chelsea nuk e shet Brojën

Një lajm i keq për AC Milanin dhe West Ham Unitedin ka ardhur nga Chelsea lidhur me të ardhmen e sulmuesit Armando Broja. Klubi anglez ka vendosur që sulmuesi shqiptar të mbetet pjesë e skuadrës të paktën edhe një vit. Kështu ka raportuar të martën "Evening Standard". Në këtë vendim të Chelseas duket se ka ndikuar edhe lëndimi i sulmuesit tjetër Christopher Nkunku.

Spanja mposht Suedinë dhe kalon në finale të Kampionatit Botëror

Spanja është Përfaqësuesja e parë finaliste në Kupën e Botës, pasi ka mposhtur Suedinë në gjysmëfinale me rezultat të ngushtë 2-1. Ka qenë një ndeshje shumë e luftuar, por për t'i parë tre golat e shënuar u desh të priten 10 minutat e fundit të kësaj sfide. Salma Paralluelo shënoi golin e parë në këtë sfidë në minutën e 81-të. Sulmuesja e Barcelonës ngriti në këmbë mijëra tifozë të pranishëm në stadiumin "Eden Park", por gëzimi i spanjolleve zgjati vetëm shtatë minuta, pasi Blomqvist barazoi shifrat në 1-1 për Suedinë. Megjithatë, spanjollet u rikthyen në lojë dhe vetëm pas një minute futbollistja Carmona Garcia realizoi golin e fitores për 2-1. Në finalen e madhe Spanja pret fituesin e duelit Australi - Angli.

Mançini: U largova për shkak të Gravinas

Roberto Mançini dy ditë pas zyrtarizimit të dorëheqjes nga pozita e trajnerit të kombëtares italiane ka vendosur të tregojë të vërtetën e këtij largimi. Tekniku italian në një intervistë të dhënë për gazetën "La Repubblica", ka thënë se dorëheqja ka ardhur si pasojë e presidentit të Federatës Italiane të Futbollit, Gabriele Gravina. "Jam përpjekur disa herë të flas me Gravinan dhe t'i shpjegoj arsyet e mia. I kam shpjeguar se muajt e fundit duhej të qetësoheshim. Nuk e bëri dhe unë dhashë dorëheqje. Ai ka disa kohë që mendon gjëra të kundërta me të miat. Por atëherë pse të ndërhyjë në staf? Çfarë lidhje ka kjo me këtë? Në atë moment ai duhej të më largonte dhe jo të më ndërhynte te stafi dhe puna ime", ka deklaruar Mançini.

Ten Hagen: Duam të fitojmë çdo trofe

Manchester Unitedi e nisi me fitore edicionin e ri në Premierligë, derisa e mposhti Wolvesin me rezultat 1-0. Trajneri i skuadrës nga "Old Trafford", Erik ten Hag, është shprehur i kënaqur me fitoren e parë dhe me këtë rast ka bërë me dije se skuadra e tij synon të fitojë çdo trofe. "E rëndësishme ishte që morëm fitoren dhe mbajtëm portën e pastër. Jam i kënaqur dhe shumë e rëndësishme është që tani duhet të shohim përpara. Po vijnë ndeshje të vështira dhe duhet të jemi bashkë sepse nuk do të jetë e lehtë. Ekipi tregoi karakter dhe përsëri tregojmë se jemi një klub i mirë. Ne jemi Unitedi, Manchester Unitedi dhe duam të fitojmë çdo trofe", ka thënë Ten Hagen.

Hamiltoni kundër Federatës: Që kur kam ardhur unë, ka vetëm meshkuj në punë

Lewis Hamiltoni njihet jo vetëm si kampion në Formula 1, por edhe si një person që thotë atë që mendon, pa u trembur nga dënimet apo kritikën që mund të ketë. Së fundmi, Hamiltoni

është përfshirë edhe në një temë të "ndezur" për momentin, aty ku po diskutohet gjithmonë e më shumë përfshirja e gjinisë femërore në garat e Formulës 1. Formula 1 është një

kompeticion ku në staf nuk ka asnjë femër, ndryshe nga Moto GP që ka të përfshira edhe femra. Diçka e tillë duket se e ka shqetësuar pilotin britanik i cili ka kërkuar që të ketë një

ndryshim dhe një gjithëpërfshirje. "Që kur kam ardhur unë në Formula 1, kam parë që ka vetëm meshkuj. Kam 16 vjet në këtë sport dhe ende nuk kam parë asnjë femër.

Mendoj se nuk i kemi dhënë rëndësi të mjaftueshme këtij problemi, por realisht nuk është diçka inkurajuese kur e dëgjon diçka të tillë", ka thënë Hamiltoni.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Kosmonte Foods” Shpk Harilaqë, F. Kosovë në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Kompaninë “Kosmonte Foods” Shpk Harilaqë, F. Kosovë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 27.09.2023 në ora 10:00 në Shkollën Fillore “Bajram Curri” Fshati Sllatinë e Madhe, Komuna e Fushë Kosovës, do të organizohet debat publik nga Kompania “Kosmonte Foods” Shpk Harilaqë, F. Kosovë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

Zoom:
Join Zoom Meeting

<https://us05web.zoom.us/j/86970660695?pwd=cwfarvrfRPICIpRktpUqT9PdQKtHh.1>

[Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Kosmonte Foods” Shpk Harilaqë, F. Kosovë, Fabrika për përpunimin e ushqimit dhe mishit të shpezëve.](#)

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “LURN” Sh.p.k. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Kompaninë “LURN” Sh.p.k. Prishtinë, për impiantin fotovoltai ZK Shajkofc, Komuna Podujevë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 28.09.2023 në ora 10:00 në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët "Hasan Ramadani" - Shajkofc, Komuna e Podujevës, do të organizohet debat publik nga Kompania “LURN” Sh.p.k. Prishtinë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

Zoom:
Join Zoom Meeting

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=GbKcoccSWx39F3e8QF7PsAkCM3bvK6.1>

[Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë “LURN” Sh.p.k. Prishtinë](#)

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Butiku “Ornela” Sh.P.K. me seli në Vushtrri, me pronar, Vullnet Ademi ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrB UNIK: 811460469 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditore nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa Butikom “Ornela” D.O.O. od Vuqiterna, sa vlasnikom Vullnet Ademi donelo odluku o prestani rada sa nrB. 811460469 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability Butik “Ornela” L.L.C. with headquarters Vushtrria, with owner Vullnet Ademi has come to the decision to quit its business: 811460469 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Butiku “Ornela” SHPK me pronar Vullnet Ademi, rr. “Sefer Dubovci”, Vushtrri, shuan biznesin me numër: 811460469.

- Drilon Ruzhdi Latifi shpall të pavlefshme INDEX-in, Psikologji Aplikative dhe Studime Menaxheriale me nr. të dosjes BA4/016-11, të Universitetit Dardania Prishtinë.

- Leona Doli nga Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e maturës të shkollës së mesme të mjekësisë “Hysni Zajmi Gjakovë.

- Agush Zenuni nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Nexhmedin Nixha” Gjakovë.

- Feride Bucolli shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore nga kl. I deri VIII, të shkollës “Fazli Grajcevc” komuna Drenas..

- Afrim Vehapi B.I. DPZ “ONIKS-1” shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, për import-export, me numër unik të biznesit: 810345654.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.



Në bazë të nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Kompania Rajonale e Mbeturinave (KRM) "Pastrimi" SH.A në Prishtinë, me datë 16.08.2023 shpall këtë:

KONKURS

Titulli i pozitës: Punëtor fizik – 20 pozita

Institucioni: Kompania Rajonale e Mbeturinave (KRM) "Pastrimi" SH.A – Prishtinë

Titulli i Mbikëqyrësit/Raporton tek: Kryepunëtori

Orari i Punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: me afat të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë: (përshkrim i shkurtër i detyrave kryesore)

- Kryen të gjitha punët fizike në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave, zbrastjen e kontenjerëve dhe pastrimin e lokacionit rreth tyre;
- Sipas planit operativ dhe urdhëresës së punës bën fshirjen/pastrimin dhe larjen e rrugëve apo pastrimin e rrugës dhe trotuareve nga bora dhe akulli, hudhjen e kripës;
- Bën largimin e qenve dhe maceve të ngordhura dhe vendosjen e tyre në kontenjer;
- Është i obliguar që të ketë sjellje korrekte ndaj qytetarëve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve;
- Është përgjegjës për përdorim të kujdesshëm të kontenjerëve dhe mjeteve të punës;
- Kryen dhe punë të tjera sipas urdhëresës së udhëheqësit.

Shkathtësitë e kërkuara: (aftësitë dhe shkathtësitë që kërkohen për këtë vend pune)

- Shkathtësi në komunikim dhe planifikim të punës;
- Aftësi bashkëpunimi, ndërpersonale si dhe pune në grup;

Kualifikimet arsimore, profesionale dhe përvoja e punës: (kualifikimet dhe përvoja që kërkohen për këtë vend pune)

- Diploma e shkollës fillore;

Konkursi është publikuar më datë 16 gusht 2023 dhe mbyllet më datë 31 gusht 2023.

APLIKACIONI: Në aplikacion duhet të bashkëngjiten dokumentet e nevojshme për konkurim, siç janë:

1. Kopja e letërnjoftimit;
2. Kopja e diplomës të shkollës fillore
3. Çertifikata e lindjes
4. Vërtetim që nuk jeni në hetime

MËNYRA E APLIKIMIT:

Formulari i aplikacionit merret dhe dorëzohet në arkivën e KRM "Pastrimi" SH.A, Rr. "Tahir Zajmi", Nr.5, Prishtinë.

Aplikimi përmes postës: Aplikacioni i kompletuar me dokumente mund të dorëzohet edhe përmes postës në adresën: Rr. "Tahir Zajmi", nr.5, Prishtinë, 10000. Aplikacionet e dërguara me postë duhet të mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim. Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merrren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 3 tri ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara, nuk do të shqyrtohen fare.

KUSHTET E PJESËMARRJES NË KONKURS:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

KRM "Pastrimi" SHA ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

VËREJTJE:

APLIKACIONET DHE DOKUMENTACIONI I PAKOMPLETUAR SIPAS KËREKSAVE TË PËRCAKTUARA NË KËTË KONKURS SI DHE ATO QË ARRINË PAS SKADIMIT TË AFATIT TË KONKURSIT, NUK DO TË SHQYRTOHEN.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi është i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit.

Për informata më të rëndësishme mund të kontaktoni në nr. tel: +383 (0) 38 603 191



Na osnovo člana 8. Zakona Br. 03/L-212 o Radu, član 4 Administrativnog Uputstva Br. 07/2017 za regulisanje tenderskih procedura u javnom sektoru, Regionalno Preduzeće za Otpad (KRM) "Pastrimi" S.A. u Prištini, od 16.08.2023 objavljuje:

KONKURS

Naziv pozicije: Fizički radnik – 20 pozicija

Institucija: Regionalno Preduzeće za Otpad (KRM) "Pastrimi" S.A – Priština

Zvanje supervizora/Izveštava: Predradnik

Radno vreme: 40 sati nedeljno

Trajanje imenovanja: sa neodređenim rokom

Dužnosti i odgovornosti: (kratak opis glavnih zadataka)

- Obavlja sve fizičke poslove na prikupljanju i utovaru otpada, pražnjenju kontejnera i čišćenju prostora oko njih;
- Po operativnom planu i radnom nalogu mete/čisti i pere kolovoze ili čisti kolovoze i trotoare od snega i leda, baca so;
- Uklanja mrtve pse i mačke i stavlja ih u kontejnere;
- Dužan je da se ponaša korektno prema građanima i korisnicima usluga;
- Odgovoran je za pažljivo korišćenje kontejnera i radnih alata;
- Obavlja druge poslove po nalogu voditelja.

Potrebne veštine: (veštine i veštine potrebne za ovaj posao)

- Veština komunikacije i planiranja rada;
- Veštine saradnje, interpersonalnog i timskog rada;

Obrazovanje, stručna sprema i radno iskustvo: (potrebne kvalifikacije i iskustvo za ovaj posao)

- Diploma osnovne škole;

Konkurs je objavljen 16 avgusta 2023 i zatvara se 31 avgusta 2023.

APLIKACIJA: Uz prijavu se prilažu i potrebna dokumenta za konkurs, kao što su:

1. Kopija lične karte;
2. Kopija diplome osnovne škole;
3. Izvod iz matične knjige rođenih
4. Dokaz da niste u istrazi.

NAČIN PRIMENE:

Prijavni formular se prima i podnosi arhivi KRM „Pastrimi“ S.A, ul. „Tahir Zajmi“, br. 5, Priština.

Prijava putem pošte: Prijava sa dokumentima se može dostaviti i poštom na adresu: Ul. "Tahir Zajmi", br.5, Priština, 10000. Prijave poslate poštom moraju biti obilježene poštanskim žigom posljednjeg dana isteka roka za prijavu. Prijave poslate poštom, koje nose poštanski žig na pošiljci učinjenog posljednjeg dana roka za prijavu, smatraće se validnim i biće uzete u obzir ako stignu u roku od 3 tri dana. Prijave koje stignu nakon ovog roka i one koje su nepotpune neće se uopšte razmatrati.

USLOVI UČEŠĆA U KONKURSU:

Svi punoletni građani Republike Kosovo koji imaju punu sposobnost da deluju, poseduju građanska i politička prava, imaju neophodnu obrazovnu pripremu i profesionalnu sposobnost za obavljanje svojih dužnosti i koji imaju fizičke sposobnosti potrebne za dotičnu poziciju imaju pravo da se prijave.

KRM "Pastrimi" S.A nudi jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Kosova i pozdravlja prijave svih lica muškog i ženskog pola iz svih zajednica na Kosovu.

BELEŠKA:

NEKOMPLETNE PRIJAVE I DOKUMENTACIJA PREMA USLOVIMA NAVEDENIM U OVOM KONKURSU KAO I ONE PRISLEPE NAKON KONKURSNOG ROKA NEĆE SE RAZMATRATI.

Biće kontaktirani samo kandidati koji uđu u uži izbor.

Konkurs je otvoren 15 dana, od dana objavljivanja.

Za važnije informacije možete se obratiti na br. telefon: +383 (0) 38 603 191



Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212, të Republikës së Kosovës, nenit 6, paragrafi 5, pika 5.1 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 8 pika 1 (a), nenit 10 pika 1 dhe 5 dhe nenit 11 pika 1 e Rregullores nr. 1074 të datës 21.08.2017 mbi Marrëdhënien e Punës, dhe Rregullores Nr.01/2022 për Organizim të Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës me nr. 1827 të datës 13.07.2022, si dhe Vendimit nr.2878 të datës 15.08.2023, Kryeshefi Ekzekutiv i NPK "Trafiku Urban" SH.A, Prishtinë, rishpall:

K O N K U R S I J A S H T Ë M

- **Pozita e punës:** Shofer i Kryeshefit Ekzekutiv
- **Numri i pozitave:** 1 (një)
- **Kohëzgjatja e punës:** Një vit me mundësi vazhdimi
- **Puna provuese:** 3 muaj
- **Niveli i pagës:** XV

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Ne lidhje me detyrat dhe përgjegjësitë për pozitën e punës mund të informoheni përmes web faqes: www.trafikurban-pr.com, në vegzën Rreth nesh, Raporte / Rregullore

Kualifikimet dhe aftësitë:

- Diplomë e shkollës së mesme
- Patentë shoferin kategoria "B";
- Përvojë pune së paku 1 vit në fushën e vozitjes në kategorinë "B";
- Aftësi të mira komunikuese dhe te jetë i gatshëm për punë ne grup;

2. Dokumentacioni i kërkuar:

- Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <https://www.trafikurban-pr.com/konkurse-pune/15/aplikacioni-per-pune>;
- Dëshmi mbi shkollimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Kopjen e patentë shoferit kategoria "B"
- Dëshmi mbi përvojën e punës
- Dëshmi nga Gjykata kompetente që nuk është duke u zhvilluar procedurë penale ndaj tij/saj, jo më të vjetër se 6 muaj;
- Kopje te certifikatave te tjera që ndërlidhen me pozitën që aplikon janë përparësi;

-Çdo përgënjeshtim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

Informata të përgjithshme:

- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim.
- Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.
- Testimi me shkrim dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim sipas ligjit.

Mënyra e Aplikimit:

Aplikimi mund të bëhet në formë fizike në pliko të mbyllura në zyrën nr. 5 të Trafikut Urban, postës apo përmes emailit : punesimi@trafikurban-pr.com, Konkursi është i hapur nga data **16.08.2023** dhe përfundon më datë **30.08.2023** deri në ora **16:00**.

NPK "Trafiku Urban" SHA

Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë

web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33



Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

Data: 15.08.2023

U prilog çlanu 8 Zakona o radu br. 03/L-212, Republike Kosovo, član 6, stav 5, tačka 5.1 Administrativnog uputstva br. 07/2017 o regulisanju postupaka konkurencije u javnom sektoru, član 8 tačka 1 (a), član 10 tačka 1 i 5 i član 11 tačka 1 Uredbe br. 1074 od 21.08.2017.godine o radnim odnosima i Uredba br.01/2022 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta br. 1827 od 13.07.2022.godine, kao i Odlukom br.2878 od 15.08.2023.godine, Izvršni direktor NPK „Trafiku Urban“ SH, Priština, ponovo objavljuje:

J A V N I K O N K U R S

- **Radno mesto:** Vozač glavnog izvršnog direktora
- **Broj pozicija:** 1 (jedan)
- **Trajanje rada:** Godinu dana sa mogućnošću produženja
- **Probni rad:** 3 meseca
- **Nivo plata:** XV

Dužnosti i odgovornosti:

O zadacima i odgovornostima na radnom mestu možete se informisati putem sajta: www.trafikurban-pr.com, u rubrici O nama, Izveštaji / Pravilnik

Kvalifikacije i veštine:

- Diploma srednje škole
- Radno iskustvo od najmanje 2 godine u oblasti vožnje u kategoriji „B“;
- Dobre komunikacijske veštine i spremnost za rad u grupi;
- Nema krivičnog postupka protiv podnosioca predstavke.

2. Potrebna dokumentacija:

- Prijava za zapošljavanje (preuzmite sa sajta TU <https://vvt.trafikurban-pr.com/konkurse-pune/15/aplikacioni-per-pune>;
- Dokaz o obrazovanju;
- Kopija lične karte;
- Kopija vozačke dozvole kategorije "B"
- Dokaz o radnom iskustvu
- Dokaz nadležnog suda da se protiv njega ne vodi krivični postupak, ne stariji od 6 meseci
- Kopije drugih sertifikata vezanih za poziciju za koju konkurišete su prednost.

-Svako falsifikovanje materijala, bilo namerno ili iz nemara, ili materijalna promena u odnosu na informacije date u gore pomenutoj izjavi, rezultiraće trenutnom diskvalifikacijom.

Opšte informacije:

- Na ovaj konkurs imaju pravo da se prijave svi građani bez razlike.
- Kompanija nudi jednake mogućnosti, podstiče i promovise angazovanje radnika, pripadnika svih zajednica i različitih polova.

- Pismeni test i intervju biće obavljani nakon isteka roka za prijavu u skladu sa zakonom.

Način primene:

Prijava se može izvršiti u fizičkom obliku u zatvorenim kovertama u kancelariji br. 5 Gradskog saobraćaja, poštom ili putem mejla: punesimi@trafikurban-pr.com, Konkurs je otvoren od 16.08.2023 i završava se 30.08.2023 do 16:00 časova. Napomena: Nepotpuna dokumenta i dokumenti koji pristignu nakon konkursnog roka neće se razmatrati.

Datum: 15.08.2023

NPK "Trafiku Urban" SHA

Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë, Kosovë

web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 45 10 11 33

